REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1126/20
Datë/Datum. 31.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Blerina Huruglica *Ekspert Shqyrtues*	*Data e autorizimit të ekspertit* *28.12.2020*	*Data e dorëzimit të raportit* *31.12.2020*

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 21.12.2020, **OE "Fidani L"NTP**, ka parashtruar ankesë me nr: **1126/20**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "BEJTA COMMERCE SH.A.; N.P.SH. "Eltoni Com"; EUROCOM SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera**" me nr. të prokurimit: **632-20-1610-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E GJAKOVËS**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 179.300,00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:
Data e njoftimit për kontratë: 24.04.2020,
Data e hapjes së ofertës:18.05.2020 ,
Data e njoftimit për dhënien e kontratës-Rivlerësimi: 08.12.2020,
Data e njoftimit të ofertuesve të pasuksesshëm-Rivlerësim:08.12.2020

Ankesa është e përsëritur, lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më **Nr.370/20 i dt:09.07.2020; PSH nr 550/20 i dt:28.09.2020.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Sa i përket pretendimeve të OE ankuesit "Fidani L":

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:

Neni 1
Neni 2
Neni 7
Neni 24 pika 2
Neni 51
Neni 56
Neni 59
Neni 60

Gjatë procedurës së aktivitetit të prokurimit Autoriteti Kontraktues në këtë rast Komuna e Gjakovës, ka bërë shkelje të Ligjit për Prokurim Publik, përkatësisht neneve të lartëcekura.

Duke devijuar nga kriteret e përzgjedhjes të vendosura në Dosjen e Tenderit.

Me rastin e rekomandimit për dhënie te kontratës, është shkelur rëndë Lpp-ja me nr.04/L-042, e plotësuar dhe ndryshuar me Lpp nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe 05/L-92. Duke shkelur Nenin 1,2,7,24, Neni 51,56 Neni 59, Neni 60.
Ku konkretisht në Nenin 59 paragrafi 4 thuhet: Autoriteti Kontraktues do të konsideroj një Tender si të përgjegjshëm, vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmeri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e Tenderit.

Pavarsisht nga e mëparshmja, Autoriteti Kontraktues mund të konsideroj një tender si të përgjegjshem nëse: (i) përmban vetëm gabimet ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetem devijime të vogla që nuk mundë të shkaktojnë ndryshime material, ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera te parashtruara në Njoftimin e Kontrates dhe në Dosjen Tenderit. Me kusht që çfarëdo devijimi i tillë të kualifikohet, aq sa është e mundshme dhe të merret parasysh gjatë vlersimit dhe krahasimit të tenderëve.

AK Komuna e Gjakovës ka rekomanduar për dhënie te kontrates Koncerziumin:
COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A; N.P.SH. "Eltoni Com"; "Eurocom" Sh.p.k.

Me rekomandimin per dhënie te kontrates këtij Koncerziumi është, shkelur rëndë Lpp-ja me nr.04/L-042, e plotësuar dhe ndryshuar me Lpp nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe 05/L-92.
Pas pranimit te vendimit nga AK Komuna e Gjakovës me dt 24.07.2020 kemi kërkuar qasje ne dokumente te Operatorve ekonomik te rekomanduar për dhënie te kontrates, gjithashtu edhe operatorve tjerë të suksesshëm. Qasja na është lejuar me dt 27.07.2020, me te hyrë në dokumentet e koncerziumit të rekomanduar për dhënie te kontrrates COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A; N.P.SH. "Eltoni Com"; "Eurocom" Sh.p.k. kemi pa qe nuk janë të përgjegjshëm me dokument dhe kerkesa nga FDT në Dosjen e Tenderit.

Dokumentet të cilat I mungojnë koncerziumit te rekomanduar për dhënie të kontratës COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A; N.P.SH. "Eltoni Com"; "Eurocom" Sh.p.k.janë:

- Kompanija COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A është caktuar si lider I grupit, mirpo me lidhjen e ofertes shohim qe lider ne paraqitjen e dosjes së tenderit është kompanija N.P.SH. "EItoni Com".
- Deklaratat Nën Betim të paraqitur në dosjen e tenderit nuk janë të marrura nga dosja e tenderit, ju mungon titulli I projektit si dhe nr I prokurimit.
- Inxhinierat si Izajdin Sylaj Gjeodeti, është Gjeodet te cilit I ka skaduar Liçensa.
- Ju mungojnë kontratat e puntorëve siç është kërkuar në FDT nga AK Komuna e Gjakovë.

- Ky koncerzium ka munges edhe tek makineritë si:

o 1 Lug Ngarkues Mungon.
o Rimorkio me targa 06-165-AX nuk ka regjistrrim
o Rimorkio me targa 06-178-XB nuk ka regjistrrhn
o Rimorkio me targa 06-408-XB e kalon peshen e kërkuar ne Dosjen e Tenderit

Të gjitha këto konstatime dhe prova vertetetojnë se koncerziumi i rekomanduar për dhënie te kontrates COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A & N.P.SH. "Eltoni Com" &"Eurocom" Sh.p.k. nuk është I pergjegjshem.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

/

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Lidhur me pretendimet e Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"; COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A.; EUROCOM SH.P.K.,

Pika 1: Dorëzimi i ofertës nga anëtari i konzorciumit (N.P.SH. "ELTONI COM), bazuar në nenin 59.4 të LPP-së, konsiderojmë se ky tenderues e plotëson kriterin që lidhet me të drejtat dhe përgiegjësitë e Grupit të Operatorëve Ekonomik të cilin e ka mbështet edhe OSHP-ja në vendimin e vet të datës 28.09.2020
Pika 2: Deklarata nën betim (mungesa e shënimit të numrit dhe emrit të projektit), konsiderohet si devijim i vogël që nuk mund të shkaktoj asnjë ndryshim material ose devijim nga karakteristikat dhe rëndësia për çka është dorëzuar.
Pika 3: Mungesa e licencës së gjeodetit apo skadimi i saj, nuk është fare licenca dhe duke u bazuar edhe në nenin 56.3 të LPP-së që thotë se asnjë kërkesë shtesë nuk guxon të aplikohet gjatë vlerësimit të tenderëve nëse nuk ka qenë e kërkuar paraprakisht në dosjen e tenderit.
Komisioni i ri-vlerësimit pas shiqimit të dokumentacionit me datë 30.11.2020 kërkoi sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së për Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"; COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A.; EUROCOM SH.P.K.
Vërejtje-Mos sjellja e këtyre dokumenteve të kërkuara në kohë ofertën tuaj e bën jo valide
Komisioni i ri-vlerësimin u mblodh me dt.01.12.2020 ku konstatoi se Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"; COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A.; EUROCOM SH.P.K., i kanë dorëzuar dokumentat e kërkuar.

Autoriteti Kontraktues me datë 01.12.2020 kërkoi nga Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"; COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A.; EUROCOM SH.P.K., i cili ishte i përgjegjshëm me çmim me ulët i ka kërkuar të sjell këto dokumentet si në vijim:
Ju lutem që në afat prej 5 ditësh të na sjellni në origjinale këto dokumente (Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës te ketë validitet 3 muaj nga data e nxerrjes, ndërsa Vërtetim nga Gjykata kompetente te ketë validitet 6 muaj nga data e nxerrjes) :
Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës - Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit - origjinali
- Vërtelim nga Gjykata kompetente - Një dokument nga Gjykata kompetente ku dëshmon se Operatori Ekonomik nuk është i falimentuar ose likuiduar - Kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar nga noteri.
- Vërtetimi nga Komuna që Operatori Ekonomik nuk ka obligime në tatim në pronë - origjinali.
Dhe - Sigurimi i tenderit origjinal
-Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet ti sjellni fizikisht
Vërejtje-Mos sjellja e këtyre dokumenteve të kërkuara në kohë ofertën tuaj e benë jo valide
Komisioni i ri-vlerësimit u mblodh me dt.04.12.2020 ku konstatoi se Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"; COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A.; EUROCOM SH.P.K., i kanë sjellur dokumentat e kërkuar.
Komisioni i ri-vlerësimit pas vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve konstatoi se si Operatorë Ekonomik më i përgjegjshëm me çmimin më të ulët është Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"; COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A.; EUROCOM SH.P.K, Madanaj,
50000, Gjakove, Kosovë, Gjakove, të cilin e rekomandon me dhënie të kontratës.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

/

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

/

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Ekspertja Shqyrtuese fillimisht sqaron, se ky aktivitet i prokurimit ka filluar me datë 24.04.2020 me Njoftimin për Kontratë, ku hapja e ofertave është bërë me datë 18.05.2020 dhe me datë 28.05.2020 AK ka rekomanduar për kontratë COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A & N.P.SH. "Eltoni Com" &"Eurocom" Sh.p.k, mirpo pas ankesave dhe vendimit të PSH 370/20 dt. 09.07.2020 ky aktivitet është kthyer në rivlerësim.
Me datë 23.07.2020 AK gjatë procesit të rivlerësimit rekomandon po të njejtin GOE COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A & N.P.SH. "Eltoni Com" &"Eurocom" Sh.p.k, përderisa prap me shqyrtimin e ankesës në OSHP, PSH 550/20 dt 28.09.2020 ky aktivitet është obliguar që të kthehet prap në rivlerësim, gjerësa me datë 08.12.2020 gjatë procesit të rivlerësimit AK ka rekomanduar prap GOE të lartëpërmenduar, përderisa OE ankuesi "Fidani L" NTP pretendon se GOE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm pasi që në ofertën e tyre mungojnë:

Dokumentet të cilat I mungojnë koncerziumit te rekomanduar për dhënie të kontratës COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A; N.P.SH. "Eltoni Com"; "Eurocom" Sh.p.k.janë:

- Kompanija COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A është caktuar si lider I grupit, miripo me lidhjen e ofertes shohim qe lider ne paraqitjen e dosjes së tenderit është kompanija N.P.SH. "Eltoni Com".
- Deklaratat Nën Betim të paraqitur në dosjen e tenderit nuk janë të marrura nga dosja e tenderit, ju mungon titulli I projektit si dhe nr I prokurimit

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimeve të lartpërmendura PSH nr 550/20 dt:28.09.2020 ka sqaruar:

dokumentet e konzorciumit të rekomanduar për dhënie të kontratës "Company Bejta Commerce Sh.A"; N.P.SH. "Eltoni Com"; "Eurocom" Sh.p.k., ku Company Bejta Commerce Sh.A. është caktuar si lider i grupit, mirëpo me lidhjen e ofertës e shohim që lider në paraqitjen e dosjes së tenderit është kompania N.P.SH. "Eltoni Com" dhe deklaratat nën betim të paraqitur në dosje të tenderit nuk janë marrë nga dosja e tenderit, ju mungon titulli i projektit si dhe numri i projektit.

Paneli Shqyrtues për këtë pretendim ankimor sqaron se OE Eltoni me datë 15.07.2020 i është drejtuar KRPP-së për interpretim me titull "Kërkesë për interpretim të lidhur me Aneksin 2-Deklarata nën Betim dhe Marrëveshjen e Konzorciumit". Kurse, me datë 29.07.2020 KRPP-ja i kthen përgjigje duke dhënë sqarime lidhur me par. 4 të nenit 59 të LPP-së, 47.19 dhe 47.21 të RRUOPP-së, Konkretisht, KRRP-ja i jep këtë sqarim anëtarit të konsorciumit: "edhe pse për KRPP-ën një gabim i tillë do të konsiderohej devijim i vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale të dosjes së tenderit, megjithatë sipas paragrafit të lartë cituar Autoriteti Kontraktues duhet të vendos vet se çështja në fjalë a mund të konsiderohet si devijim i vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit", Pra ky pretendim eshte pjesërisht i bazuar.

Dmth KRPP ka lënë në diskrecion të AK-së.

Pretendimi i rradhës nga OE ankuesi për të rekomanduarin:

- Inxhinierat si Izajdin Sylaj Gjeodeti, është Gjeodet te cilit I ka skaduar Liçensa.
- Ju mungojnë kontratat e puntorëve siç është kërkuar në FDT nga AK Komuna e Gjakovë.

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimeve sqaron se, ka nji vendim të PSH 550/20 dt.28.09.2020:

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Berisha Com" sh.p.k – Gjakovë se gjeodetit Izajdin Syla i ka skaduar licenca, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK duhet që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së që të konfirmoj nëse i njëjti ka licence valide. Sa i përket pretendimit se OE të rekomanduar i mungojnë kontratat e punëtorëve siç është kërkuar në FDT nga AK, Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim është i bazuar dhe se AK duhet të kërkoj sqarime nëse i njëjti posedon këto kontrata konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se, sa i përket Licencës po ashtu AK në Njoftimin për kontratë nuk ka cekur se kërkohet Licenca valide, andaj pretendimi nuk gjendet i bazuar.
Ndërsa sa i përket kontratave të punëtorëve, GOE i rekomanduar ka bashkangjitur kontratat e punëtorëve në E-prokurim me datë 30.11.2020, dhe shihet se kontratat janë valide dhe vërtetohet se këto kontrata kanë qenë para hapjes si dhe nuk paraqesin ndryshim material konform LPP_së dhe Rruopp-së, sepse nuk janë kontrata mbi vepër por janë kontrata pune me kohë të caktuar/pacaktuar të nënshkuara kryesishtë para hapjes e cila është e dëshmuar edhe me listën e ATK-së.

Pretendimi i fundit nga OE ankuesi për të rekomanduarin:

Ky koncerzium ka munges edhe tek makineritë si:
o 1 Lug Ngarkues Mungon.
o Rimorkio me targa 06-165-AX nuk ka regjistrrim
o Rimorkio me targa 06-178-XB nuk ka regjistrrhn
o Rimorkio me targa 06-408-XB e kalon peshen e kërkuar ne Dosjen e Tenderit

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimet e fundit sqaron se, për pretendimet e njejta është një vendim i PSH 370/20 dt 09.07.2020

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE te rekomanduar për dhëni te kontratës ka mungesë edhe tek makineritë si: • 1 Lug Ngarkues Mungon. Paneli shqyrtues konform Eksperti Shqyrtues konstaton se pretendimi është i bazuar pretendimin për faktin se pajisja • Rimorkio me targa 06-165-AX nuk ka regjistrim. • Rimorkio me targa 06-178-XB nuk ka regjistrim. Paneli shqyrtues konstaton se ne baze te provave te ofruara vërtetohet se regjistrimi makinerisë ju ka skaduar para aplikimit, andaj ne pajtim me nenin 59.4 dhe 72 te LPP-se AK ka mundur te kërkoj sqarime për këto dëshmi.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Rimorkio me targa 06-408-XB e kalon peshën e kërkuar në Dosjen e Tenderit. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi i ankuesit ne ketë pike është i bazuar sepse duke u bazuar në kërkesën e AK-së tek FDT pika 9.1& 9.2 FDT Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe ose profesionale 9.1&9.2-eshte kërkuar nje rimorkio deri në 40 ton), ndërsa OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka ofruar librezë shihet që pesha e makinës se cekur si me lart është 80000 .

Si përfundim, Ekspertja Shqyrtuese i rekomandon AK-së, që procesin e reverësimit ta bëjë konform LPP-së dhe Rruopp-së, duke respektuar vendimet e OSHP-së 370/20 dhe 550/20, gjithashtu sa i përket makinerisë sipas pretendimit të fundit për GOE të rekomanduarin, AK të verifikoj dhe analizoj se a i përmbushin kriteret sipas FDT-së pasiqë në ofertën e GOE të rekomanduarit ka më tepër makineri të ofruara se sa që kërkohet nga AK, andaj AK të përqëndrohet tek kërkesa sipas FDT-së. Po ashtu në raport të rivlerësimit të bëjë sqarimin e qartë me rastin e eliminimit dhe përzgjedhjes së Ofertuesve, **pasi që AK në kërkesat për rishqyrtim të OE ankuesit nuk ka dhënë sqarimet e detajuara dhe përgjigje në pretendimet, me qëllim që ofertuesit/ankuesit të mirkuptojnë vendimin e AK-së.**

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja Shqyrtuese i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjesërishtë, vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KOMUNA E GJAKOVËS.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - **OE "Fidani L"NTP**